



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**Komuna e Prishtinës**  
**Opština Priština -Municipality of Prishtina**



Në bazë të nenit 3, pika 3.1, shkronja **b** dhe **h** të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2007/30, për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut nr 200/45, për vetëqeverisjen e komunave të Kosovës, dhe të nenit 16, shkronja **b** dhe **h** të Statutit të Komunës së Prishtinës, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 21.5.2008. merr

**V E N D I M**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIM E VENDIMIT 01. Nr. 353-87, dt, 21.2.2006, PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E KATËR OBJEKTEVE TË TËRËSISË SË PËRBASHKËT (KOLEKTIVE) NË FSHATIN GRAÇANICË**

**Neni 1**

Neni V ndryshon dhe në të thuhet:

“Kuvendi i Komunës së Prishtinës përcakton Komisionin për caktimin e kushteve dhe kritereve për ndarjen e banesave.

Komisioni, nga paragrafi 1 i këtij neni, përbëhet nga përfaqësuesi i Këshillit të Drejtorëve të Komunës së Prishtinës - organit pasues të këtij këshilli, nga përfaqësuesi i Zyrës për komunitete në Komunën e Prishtinës, përfaqësuesi i donatorit ndërkombëtar dhe nga partneri implementues. Kuvendi i Komunës, sipas nevojës, mund të caktojë edhe anëtarë të tjerë të këtij komisioni”.

**Neni 2**

Neni VI ndryshon dhe në të thuhet:

“Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Komuna e Prishtinës, përmes organeve të saj ekzekutive”.

**KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS**

**01.Nr. 353-624,më 21.5.2008**

**KRYETAR I KOMUNËS**  
**Prof.dr. Isa Mustafa**